



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË**

**NOTER AIDA A. HOXHA  
ADRESA MINE PEZA, NR.83/1  
TEL: 689090075**

## **AKT MARRËVESHJE**

**Nr. repertori: 2229**

**Nr. koleksioni: 731**

**Tirane më 15/05/2025**

**Ligjet referuese:**

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 124/2024, datë 19/12/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale"
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

**\*Akti noterial përbëhet nga 6 fletë**



A2025051010079946625



A2025051010079946625

## AKT MARRËVESHJE PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË SË THJESHTË

Sot, më datë 15 Maj 2025 (dymijënjëzetëepesë), para meje Notere AIDA A. HOXHA, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tiranë, MINE PEZA, NR.83/1, u paraqitën personalisht:

**PALA 1: Frenklind Prifti**, atësia Izold, amësia Lindita, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Ali Visha; Nd. 10; H. 1; Njësia Administrative Nr. 2; Njësia Bashkiake Nr. 2; 1003; Tiranë, lindur më 12/06/1991, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me dokument identiteti me nr. personal J106120810 , .

**PALA 2: Kliti Likaj**, atësia Besnik, amësia Mimoza, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Konti Leopold Bertold; Nd. 6; H. 1; Ap. 9; Njësia Administrative Nr. 1; Njësia Bashkiake Nr. 1; 1004; Tiranë, lindur më 10/08/1991, gjendja civile “beqar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me dokument identiteti me nr. personal J10810062E, .

### Rrethanat e hartimit të aktit noterial:

Personat e lartpërmendur u paraqitën me vullnetin e tyre të lirë, të plotë e të pavesuar dhe deklaruan se kërkojnë hartimin e kësaj aktmarreveshje për krijimin e shoqërisë së thjeshtë. Unë noterja, pasi verifikova identitetin e tyre dhe dokumentet e paraqitura, hartoj këtë kontratë, në bashkëpunim me palët, duke përcaktuar kushtet e mëposhtme:

### DEKLARIME PARAPRAKE

- A.** Pala e Pare ka njohuri të zhvilluara profesionale për rekrutimin e punemarresve jashtë Shqipërisë. Me tej Pala e Pare ka aftësitë e duhura ligjore për të kryer çdo shërbim lidhur me sigurimin e vizes dhe lejes së qëndrimit në Shqipëri për shtetasit e huaj për çdo qëllim ligjor në bazë të të cilit ata kërkojnë të jetojnë dhe/ose të punojnë në Republikën e Shqipërisë.
- B.** Pala e Dyte ka një portofol të zhvilluar klientesh të zhvilluar nga aktiviteti tregtar kryesor që kryen prej më shumë se 10 vitesh përmes agjencisë së udhëtimit Ana Travel. Rrjeti i klientëve që përbejnë individë dhe biznese kanë interes të punësojnë shtetas të huaj me kosto të ulët jashtë Republikës së Shqipërisë dhe t'i ofrojnë këtyre të fundit akomodim dhe punësim sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
- C.** Pala e Pare vepron si Partneri i Shërbimeve Juridike dhe Pala e Dyte vepron si Partneri i Zhvillimit të Klienteles. Me qëllim bashkimit të njohurive dhe ofrimit të shërbimit të furnizimit me punëmarres me kosto të ulët nga jashtë të individëve dhe bizneseve në Republikën e Shqipërisë, Palët përmes kësaj marrëveshje kanë vendosur të bashkëpunojnë duke bashkuar njohuritë dhe aftësitë e tyre për të themeluar një shoqëri të thjeshtë për ofrimin e shërbimeve të rekrutimit dhe ofrimit të shërbimeve ligjore për jetesën dhe punësimin e rregullt të të huajve në Republikën e Shqipërisë (me tej “**Marrëveshja**”).
- D.** Palët, të vetdijshme për rëndësinë strategjike të bashkëpunimit të tyre dhe vlerën tregtare të informacionit, klienteles dhe metodologjisë së përbashkët të punës që do të zhvillohet në kuadër të kësaj Shoqërie të Thjeshtë, angazhohen të respektojnë parimet e besnikërisë kontraktore, të moskonkurrencës dhe mbrojtjes së klienteles, si dhe të mos përdorin apo përvetësojnë për



A2025051010079946625

qellime personale apo te paleve te treta asnje informacion, klient, kontakt apo burim i cili buron nga aktiviteti i shoqerise se thjeshte, si gjate kohezgjatjes se saj ashtu edhe per nje periudhe te caktuar pas zgjidhjes se saj, sipas kushteve te percaktuara ne kete Marreveshje.

*Ne kuptim te Deklarimeve Paraprake me siper, ne kuptim te neneve 1074 e vijues, ne pjesen e V, tituli II, kren XXII te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise, Palet lidhin kete Marreveshje sipas kushteve dhe afateve si vijon:*

## **Neni 1**

### **Themelimi i Shoqerisë së Thjeshtë**

**1.1.** Pala e Pare dhe Pala e Dyte themelojne nje Shoqeri te Thjeshte ("Shoqeria"), pa personalitet juridik te veçante, per te bashkuar, ekspertizen dhe burimet e tyre, ne menyre qe te realizojne objektin e shoqerise se thjeshte ne kete Marreveshje.

**1.2.** Emri tregtar i shoqerise se thjeshte do te jete "Infinity Hiring", i ndjekur nga akronimi "Thiring JV" (me tej referuar si "Shoqeria e Thjeshte").

## **Neni 2**

### **Selia e Shoqerise se Thjeshtë**

**2.1.** Selia e Shoqerise se Thjeshte eshte ne adresen: rruga " Ndre Mjeda" kompleksi "Star", Tiranë.

**2.2.** Shoqeria e Thjeshte mund te hape dhe adrese dytesore per ushtrimin e objektit te saj te veprimtarise.

## **Neni 3**

### **Objekti i Shoqerise se Thjeshte**

**3.1.** Objekti kryesor i Shoqerise se Thjeshte eshte:

- Identifikimi, perzgjedhja dhe rekrutimi i punonjesve te huaj, duke ofruar nje alternative konkurruese te fuqise punetore per bizneset shqiptare;
- Keshillimi dhe asistenca ligjore ne procesin e pajisjes se punonjesve te huaj me dokumentacion te plote per qendrim dhe punesim te ligjshem ne territorin e Republikes se Shqiperise, perfshire vizat e punes, lejet e qendrimit dhe lejet e punes;
- Menaxhimi i procesit te aplikimit dhe ndjekjes prane autoriteteve kompetente shtetore dhe lokale;
- Sigurimi i mbeshtetjes se vazhdueshme ligjore dhe administrative per subjektet punedhenese gjate gjithë ciklit te marredhenieve te punes me te huajt;

duke operuar veçanerisht ne keto industri strategjike:

- Ndertim: perfshire punetore krahu, teknike ndertimi dhe mjeshtra te specializuar;
- Hoteleri dhe Turizem: perfshire pastrues, mirembajtes, staf sherbimi dhe kuzhinier ndihmes;
- Industria fason: perfshire qepes dhe punonjes linje;
- Agropërpunim dhe Ushqim: perfshire ambalazhim dhe perpunues te produkteve bujqesore;
- Logjistike dhe Transport: perfshire punonjes magazinash dhe operatore ndihmes;
- Sherbime te Pergjithshme: perfshire mirembajtje ambientale dhe mbeshtetje operative.



A2025051010079946625

Me tej Shoqeria e thjeshte mund te kryejë dhe veprimtari dytesore duke dhene sherbime te vecanta per sigurimin e lejeve te qendrimit te shtetasve te huaj qe kane per qellim te jetojne ne menyre te perkohshme ose te perhershme ne Republiken e Shqiperise per qellime te ndryshme nga punesimi ose turizimi.

3.2. Palet mund te bien dakord per te zgjeruar objektin e Shoqerise me marreveshje te vecante te bere me shkrim.

#### **Neni 4**

##### **Kontributet e Paleve**

4.1. Secila Pale e kesaj Marreveshje, do te kontribuojë ne Shoqeri ne menyre te barabarte, por ne forma te ndryshme:

3.1.1. Pala e Pare ose Partneri i Sherbimeve Juridike do te kontribuojë permes njohurive te thelluara juridike dhe pervojës ne menaxhimin e procedurave te legalizimit te punesimit dhe qendrimit te punemarresve te huaj ne vecanti dhe/ose shtetasve te huaj ne pergjithesi;

3.2.2. Pala e Dyte ose Partneri i Zhvillimit te Klienteles do te kontribuojë permes rrjetit te tij te konsoliduar te kontakteve tregtare dhe kapacitetit per te siguruar kliente te interesuar per sherbimet e ofruara nga Shoqeria e Thjeshte"

4.2. Palet e kesaj Marreveshje do te kontribuojne ne menyre te barabarte lidhur me shpenzimet e themelimit te Shoqerise se Thjeshte, shpenzimeve te kryera per fushaten e marketingut te sherbimeve dhe shpenzimeve te tjera per lidhjen me mbarevatjen e aktivitetit tregtar qe mund te lindin rast pas rasti pervecse shpenzimeve per qirane e selise se Shoqerise se Thjeshte qe do te mbarten ekskluzivisht nga Pala e Dyte.

#### **Neni 5**

##### **Administrimi dhe Perfaqesimi**

5.1. Shoqeria e Thjeshte do te administrohet nga Pala e Dyte. , nga data 15.05.2025-15.05.2028.

5.2. Pala e Dyte lidhur me cdo vendim duhet te marre nje mendim paraprak nga Pala e Pare me shkrim, e cili mund te kryhet ne cdo medium email, whatsapp, ose cdo rrjet tjeter komunikimi elektronik qe permban komunikime me shkrim.

5.3. Asnje Pale e kesaj Marreveshje nuk mund te kryejë veprime qe tejkalojne administrimin e zakonshem pa pelqimin me shkrim te Pales tjeter. Autorizohet Pala e Pare per regjistrimin e kesaj marreveshje ne QKB.

#### **Neni 6**

##### **Ndarja e Fitimeve dhe Shpenzimeve**

6.1. Fitimet dhe humbjet qe rrjedhin nga veprimtaria e Shoqerise se Thjeshte do te ndahen ne menyre te barabarte, perkatesisht 50% per secilen Pale, pervecse kur ndryshe percaktohet me marreveshje te vecante me shkrim.

6.2. Kapitali i Shoqerise eshte 100 leke dhe secila pale eshte mbajtese e 50% te fitimeve dhe humbjeve qe rrjedhin nga veprimtaria e shoqerise sipas paragrafit 6.1.



A2025051010079946625

## **Neni 7**

### **Pergjegjesia**

7.1. Palet mbajne pergjegjesi personale, te pakufizuar dhe solidare per detyrimet qe rrjedhin nga veprimtaria e Shoqerise se Thjeshte ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

## **Neni 8**

### **Zgjidhja e Mosmarreveshjeve**

8.1. Çdo mosmarreveshje qe lind nga kjo Marreveshje do te zgjidhet fillimisht nepermjet negociatave te ndershme dhe ne mirebesim midis Paleve.

8.2. Nese negociatat deshtojne, mosmarreveshja do t'i referohet per zgjidhje Gjykates se Shkalles se Pare te Juridiksionit te Pergjithshem Tirane.

## **Neni 9**

### **Kohezgjatja e Shoqerise se Thjeshte**

9.1. Shoqeria krijohet me nje kohezgjatje te pacaktuar dhe mund te mbyllet ne çdo kohe me marreveshje te ndersjelle te Paleve.

## **Neni 10**

### **Moskonkurrenca dhe Mbrojtja e Klienteles**

10.1. Secila nga Palet e kesaj Marreveshje, per sa kohe kjo Shoqeri e Thjeshte eshte aktive dhe per nje periudhe dy (2) vjet pas perfundimit apo zgjidhjes se saj, angazhohet qe te mos ushtroje individualisht ose permes personave te tjere, direkt apo indirekt, ndonje aktivitet konkurrues, te njejte ose te ngjashem me objektin e kesaj Shoqerie, brenda territorit te Republikes se Shqiperise.

10.2. Palet ndalohen te afrojne, rekrutojne, pervesojne apo te ofrojne sherbime te ngjashme me ato te Shoqerise se Thjeshte per klientet ekzistues apo te meparshem te Shoqerise, pa pelqimin me shkrim te Pales tjeter. Ky ndalim zbatohet per nje periudhe dy (2) vjet pas daljes se tyre nga Shoqeria ose zgjidhjes se saj.

10.3. Palet gjithashtu ndalohen te rekrutojne punonjes, bashkepunetore, partnere komerciale apo persona te trete qe kane pasur marredhenie pune apo bashkepunimi me Shoqerine e Thjeshte, per te ofruar sherbime te ngjashme ne menyre te pavarur apo ne konkurrence me Shoqerine, per te njeiten periudhe te percaktuar ne piken 10.1.

10.4. Shkelja e ketij neni perben shkelje te rende kontraktore dhe i jep te drejten Pales tjeter te kerkoje demshperblim per çdo dem te shkaktuar, perfshire fitimin e munguar, si dhe nderhyrje gjyqesore per ndalimin e aktivitetit konkurrues nepermjet masave te sigurimit apo mjeteve te tjera ligjore ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

## **Neni 11**

### **Konfidencialiteti**

11.1. Palet angazhohen te ruajne konfidencialitetin mbi te gjitha informacionet e ndersjella tregtare, ligjore, teknike, financiare, operationale apo personale qe mesohen gjate dhe ne lidhje me kete Marreveshje dhe aktivitetin e Shoqerise se Thjeshte, perfshire por pa u kufizuar tek: Klientet, procedurat, dokumentacioni ligjor, tarifet, kontratat me pale te treta dhe çdo forme tjeter te te dhenave sensitive.





A2025051010079946625

11.2. Informacioni konfidencial nuk do te perdoret nga asnjera Pale per qellime personale ose konkurruese ndaj Shoqerise se Thjeshte, dhe nuk do te zbulohet ndaj asnje pale te trete pa pelqimin me shkrim te Pales tjeter, pervec rasteve kur kerkohet nga ligji.

11.3. Ky detyrim per konfidencialitet mbetet ne fuqi edhe pas perfundimit te kesaj Marreveshjeje per nje periudhe prej pese (5) vjetesh, pervec rasteve kur Palet me marreveshje te posaçme bien dakord ndryshe.

## Neni 12

### Te ndryshme

12.1. Kjo Marreveshje zevendeson te gjitha komunikimet dhe klauzolat e meparshme kontraktore me shkrim dhe me goje. Çdo ndryshim i kesaj Marreveshje eshte i vlefshem vetem nese eshte nenshkruar rregullisht nga te gjitha palet dhe atehere do te konsiderohet pjese perberese e kesaj Marreveshje. Kjo Marreveshje e ruan fuqine e saj ligjore dhe i shtrin efektet e saj edhe mbi trashegimtarete e paleve kontraktuese.

12.2. Çdo njoftim, kerkese apo çdo lloj komunikimi i lejuar per t'u dhene ne baze te kesaj Marreveshje ndermjet paleve, do te behet me shkrim.

12.3. Ndryshimet ose amendimet e kesaj Kontrate jane te vlefshme vetem me shkrim dhe te nenshkruara rregullisht nga palet. Kjo Kontrate nenshkruhet n 4( katër) kopje.

12.4. Ne rast se forca madhore jane bere pengese per realizimin e detyrimeve te pershkruara ne kete Marreveshje, palet bien dakort qe t'i japin njeri-tjetrit nje afat te dyte per permbushjen e ketyre detyrimeve, duke u shtyre afati, per aq kohe sa ka ekzistuar kushti qe ka shkaktuar pezullimin e permbushjes se detyrimit.

12.5. Nese nene te kesaj Marreveshje jane ose behen te pavlefshme ose jodetyruese, Palet do te jene te detyruara te zbatojne pjesen tjeter te Marreveshjes qe eshte e vlefshme. Ne kete rast, Palet do te zevendesojne pjesen e pavlefshme ose jodetyruese me parashikime te vlefshme e detyruese - efektet e te cilave sipas permbajtjes dhe qellimeve te kesaj Marreveshje – duhet te jete ne kufijte e te mundshmes.

12.6. Secila nga Palet e kesaj Marreveshje do te kryeje ato veprime te metejshme dhe do te nenshkruaje dokumente te tjera te nevojshme per te kryer e per t'i dhene fuqi te plote parashikimeve te kesaj Marreveshje dhe qellimeve te Paleve te pasqyruara ne te.

12.7. Kjo Marreveshje eshte hartuar ne baze te legjislacionit shqiptar dhe konkretisht Kodit Civil te Republikes se Shqiperise. Çdo mosmarreveshje qe mund te lindi nga interpretimi ose zbatimi i kushteve te kesaj Marreveshje midis paleve, do te zgjidhet me bisedime dhe mirekuptim te ndersjellte midis paleve, ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi. Çdo kusht apo formulim qe mund te sjelle paqartesi do te interpretohet ne konteksin e teresise se Marreveshjes dhe ne kendveshtrimin e qellimit qe i shtyu palet te lidhnin kete Marreveshje.

## Neni 13

### Hartimi dhe Hyrja ne Fuqi e Marreveshjes

13.1. Marreveshja, hartohet ne 4 (kater) kopje te barasvlefshme ne gjuhen shqipe. Nje kopje arkivohet ne arkiven e Noterit. Detyrimet dhe te drejtat qe burojne nga kjo Marreveshje fillojne efektet e tyre nga momenti i nenshkrimtit te saj.



A2025051010079946625

13.2. Palet pasi e lexuan, konstatuan se e gjejne te rregullt Marreveshjen dhe ne perputhje me vullnetin e tyre te lire dhe te plote, e nenshkruajne para meje. Une Noterja vertetoj nenshkrimet e tyre sipas ligjit nr. 110/2018 "Per Noterine".

Në zbatim të ligjit nr. 124/2024 datë 19/12/2024" Për mbrojtjen e të dhënave personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij akti, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**PALE**

**Frenklind Prifti**

**Kliti Likaj**

**NOTER  
Aida A. Hoxha**

